



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJE
KESHILLI I BASHKISE

VENDIM

Nr.116 Date 24/12/ 2019

PER MIRATIMIN E KALENDARIT PER PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2021 – 2023 DHE BUXHETIN VJETOR 2021

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 date 17.12.2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, neni 54, germa e), Ligjit Nr.68/2017 “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”, Kreu VII, neni 33-41, me propozim te Kryetarit te Bashkise , Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates 24/12/2019

VENDOSI:

1. Kalendarin e programit buxhetor afatmesem 2021-2023 dhe buxhetit vjetor 2021 si me poshte:
 - Kalendarin miratohet nga Keshilli jo me vone se date 31 Dhjetor dhe hyn ne fuqi dite e pare te cdo viti buxhetor.
 - 03-31 Janar 2020 Kryetari i Bashkise paraqet ne Keshillin Bashkiak raportin e vleresimit dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave per
 - d. Dy vitet e para vitit buxhetor (2018-2019),
 - e. Vitin buxhetor 2020 dhe
 - f. Tre vitet e ardheshme 2020-2022;
 - Keshilli i Bashkise miraton raportin e vleresimit jo me vone se data 1 Mars 2020.
 - Bazuar ne vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave dhe transfertave te pakushtezuara GMS dhe Drejtuesit e Ekipeve te Menaxhimit te Programeve pergatitin tavanet e shpenzimeve ne nivel programi dhe Keshillit i Bashkise miratontavanet e shpenzimeve per PBA 2021 – 2023 jo me vone se data 15 Mars 2020
 - Kryetari i Bashkise pas miratimit ne Keshill te tavanave pergatitore te shpenzimeve deri date 20 Mars 2020 miraton udhezimin e pergatitjes se PBA dhe e shperndan tek njesite shpenzuese ne bashki;
 - Programi buxhetor afatmesem miratohet nga Keshilli i Bashkise me propozim te Kryetarit te Bashkise;
 - Brenda dates 01 Qershor 2020 Kryetari i Bashkise i dergon Ministrise se Financave projekt dokumentin e PBA 2021 – 2023;
 - Brenda date 20 Qershor 2020 Ministria e Financve pergatit nje raport me mendime mbi projekt dokumentin e PBA;
 - Projekti se bashku me mendimet zyrtare te Ministrise se financave i paraqitet Keshillit t Bashkise dhe brenda dates 30 Qershor 2020 Keshilli miraton projektin e pare te PBA duke shprehur opinionin e tij per rekomandimet e Ministrise se Financave;

- Brenda dates 05 Korrik 2020 Kryetari i Bashkise merr masat per publikimin e dokumentit te pare te PBA;
 - Bazuar ne parashikimet e perditesuara te te ardhurave dhe transfertave , Kryetari i Bashkise paraqet per miratim ne Keshill tavanet perfundimtare te shpenzimeve te PBA ne nivel programi . Keshilli i Bashkise miraton tavanet perfundimtare brenda dates 20 Korrik 2020;
 - Jo me vone se 5 dite nga miratimi i tavanëve perfundimtare Kryetari i Bashkise nxjerr udhezimin plotesues per pergatitjen e buxhetit te bashkise dhe e shperndan tek njesite shpenzuese;
 - Pas marrjes se udhezimit plotesues te Ministrise te Financave, Kryetari i Bashkise pergatit PBA te rishikuar;
 - Ne muajt Gusht – Shtator pas finalizimit te PBA te rishikuar, Kryetari i Bashkise ben publikimin e tij dhe organizon seanca degjimore me komunitetin dhe grupet e interesit dhe proces verbalet e takimeve behen pjese e dokumentit te PBA;
 - Brenda 15 Shtator te vitit 2020, Keshilli i Bashkise miraton PBA e rishikuar, bashkia dergon ne Ministrine e Financave PBA e rishikuar se bashku me nje informacion mbi rekomandimet e dhena nga MF gjate fazes se pare;
 - Brenda dates 5 Tetor Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njesite vendore;
 - Brenda dates 20 Tetor Ministria e Financave dergon mendimet perfundimtare per tu reflektuar ne dokumentin final te PBA
 - Kryetari i Bashkise brenda dates 30 Nentor paraqet per shqyrtim dhe miratim projektin e PBA perfundimtar se bashku me mendimet e Ministrise te Financave dhe vleresimin e tij per marrje ne konsiderate te tyre;
 - Gjithashtu Kryetari i Bashkise paraqit ne Keshill per miratim p/buxhetin vjetor jo me vone se data 30 Nentor e vitit buxhetor
 - Projekt buxheti vjetor permban vitin e pare te PBA;
 - Cdo anetar keshilli mund te propozoje ndryshime te argumentuara te projekt-buxhetit te paraqitur nga kryetari
 - PBA 2021-2023 perfundimar miratohet nga Keshilli i Bashkise jo me vone se data 25 Dhjetor 2020
 - Ne rast se Projekt buxheti nuk miratohet nga Keshilli brenda dates 25 Dhjetor jo me vone se data 5 Janar i vitit pasardhes Prefekti kerkon thirrjen e mbledhes se dyte te Keshillit
 - Ne rast te mosmiratimit te buxhetit, Kryetari i Bashkise zbaton procedurat per buxhetin e perkohshem vendor
 - Jo me vone se 15 dite nga miratimi i buxhetit ne keshill, Kryetari merr masa per publikimin e tij ne Buletinin e Njoftimeve Publike dhe ne faqen zyrtare te bashksie
 - Jo me vone se 5 dite nga miratimi i buxhetit vjetor, dergohet ne Ministrine e Financave
4. Per zbatimin e Kalendarit te programit buxhetor afatmesem ngarkohen Kryetari i Bashkise, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, Njesite shpenzuese dhe Keshilli i Bashkise
5. Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit nga prefektura.

KRYETARI I KESHILLIT TE BASHKISE

